



BACHELOR

INXHINIERI PYJORE

NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN BOKU

Pse ky program studimi?

Kjo diplomë, në bashkëpunim me **Univesitetin BOKU**, kombinon aftësitë tekniko-profesionale dhe krijuese, duke përgatitur studentët për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave.

Përmes përvojës praktike, studentët zhvillojnë aftësi në vlerësimin dhe qeverisjen e burimeve natyrore në përputhje me parimet e qëndrueshmërisë, duke hapur mundësi karriere si vlerësues, menaxhues, hartues dhe zbatues projektesh.


Programi është ideal për ata që synojnë të kontribuojnë në mbrojtjen dhe zhvillimin e ekosistemeve pyjore, biodiversitetit dhe mjedisit, ndërsa përdorimi i teknologjive inovative në projekte shkencore ndihmon në përmirësimin e cilësisë së jetës.



Përshkrimi i programit

Programi Bachelor në Inxhinieri Pyjore përgatit specialistë për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, duke kombinuar njohuri shkencore me praktikë në terren. Studentët fitojnë aftësi në vlerësimin e burimeve natyrore, planifikimin hapësinor dhe zbatimin e metodave moderne, miqësore me mjedisin, për zhvillimin e ekosistemeve pyjore dhe kullimore.

**Diplomë që njihet
ndërkombëtarisht**



Profili i të diplomuarit / Profil profesional

Të diplomuarit në Inxhinieri Pyjesh formohen si profesionistë me aftësi teknike, menaxheriale dhe mjedisore, të gatshëm për të menaxhuar dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme burimet pyjore dhe natyrore. Ata mund të ushtrorjnë profesionin si:

- **Inxhinier pyjesh**, i angazhuar në planifikim, inventarizim dhe menaxhim të ekosistemeve pyjore;
- **Specialist mjedisor/analist ndikimesh**, në institucione publike, agjenci mjedisore dhe struktura vendore;
- **Ekspert** projekte zhvillimi dhe mbrojtjeje natyrore, në organizata joqeveritare dhe projekte kombëtare/ndërkombëtare;
- **Konsulent** për përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, në sektorin privat dhe kompani që operojnë në pyje dhe resurse natyrore.



Albora Kacani

Federata Kombëtare e Pyjeve
dhe Kullotave Komunale

“Pyjet janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien e njerëzve, dhe bashkëpunimi i specialistëve të shkencave pyjore është kyç për të ofruar zgjidhje konkrete, praktike dhe të qëndrueshme për të ardhmen.”



Erion Istrefi

Ekspert i Mjedisit në Zyrën e
Bankës Botërore në Tiranë

“Shqipëria është veçanërisht e ndjeshme ndaj ndryshimeve klimatike si përmbytjet, zjarret dhe thatësira. Menaxhimi i riskut mjedisor dhe fondi pyjor luajnë rol kyç në zhvillimin e qëndrueshëm, duke siguruar ushqim, ujë të pastër dhe burime të tjera të rëndësishme për komunitetet lokale dhe ekonominë e vendit.”



Ardmir Doda

Drejtor të Administrimit të Pyjeve
dhe Kullotave, Fushë-Arrëz

“Zgjedha Inxhinieri Pyjore për të kontribuar në mbrojtjen e natyrës dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve. Studimet më dhanë njohuri dhe aftësi praktike për një karrierë me ndikim real në mjedis dhe komunitet.”



Ilda Metani

Menaxhere Projekti “EcoAlbania”

“Nëse dëshironi të kontribuoni në mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, Inxhinieria Pyjore ju ofron formimin e nevojshëm për një karrierë me ndikim real në natyrë, komunitet dhe zhvillim të qëndrueshëm.”

Kompetencat kryesore të fituara

Në përfundim të programit, studentët fitojnë kompetenca në:

- Vlerësimin e saktë të grumbujve pyjorë nga pikëpamja silvikulturore dhe ekonomike.
- Menaxhimin e pyjeve dhe kullotave në mënyrë të qëndrueshme.
- Zgjedhjen e një forme më të mirë të qeverisjes së grumbujve pyjorë.
- Zbatimin me sukses të projekteve të ndryshme në pyje dhe kullota.
- Vlerësimin e shërbimeve dhe produkteve nga ekosistemet pyjore dhe kullosore
- Aplikime të bioekonomisë pyjore në praktikë

PËRMBAJTJA E STUDIMEVE

LËNDËT BAZË

Module bazë në Fizikë, Botanikë dhe Ekologji, Politikë dhe Ligj, Statistikë, Inteligjenca artificiale, kontrolli i erozionit dhe Shkencat e Tokës etj

LËNDËT KARAKTERIZUESE

Lëndë inxhinierike I, Lëndë inxhinierike II, Silvikulturë, Mbarështrim pyjesh, Teknologji druri, Aplikime të GIS dhe remote sensing, etj.

TË TJERA

Administrim biznesi, Bazat e ekonomisë, Politikë dhe legjislacion, Bazat e politikave dhe ligjet, Tregu dhe marketingu, etj

Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve interaktive, seminareve, ushtrimeve praktike dhe punës laboratorike. Programi përfshin punë laboratorike të strukturuar, projekte studimore dhe praktikë profesionale të detyrueshme.

Mundësi Punësimi:

- Administrata pyjore dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
- Bashki dhe qarqe kombëtare
- Projekte mjedisore dhe organizata joqeveritare (OJF)
- Kompani druri dhe ndërmarrje bujqësore-pyjore
- Konsulencë mjedisore dhe planifikim territorial
- Projekte ndërkombëtare për biodiversitetin, klimën dhe zhvillimin rural

Të dhënat e programit

Niveli i studimit

Cikli i parë, Bachelor

Titulli akademik

Bachelor në Inxhinieri Pyjore

Kohëzgjatja

3 vite akademike / 6 semestra

Kredite

180 ECTS

Forma e studimit

Me kohë të plotë

Gjuha e studimit

Shqip / Anglisht

Kuota studimi

30 studentë

Përfundimi i studimeve

Provim formimi / Temë diplome



Rreth UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës u themelua më 1 nëntor 1951 dhe prej vitit 1956 është vendosur në Kodër Kamëz. Që nga krijimi, ai ka qenë një shtyllë e arsimit dhe kërkimit bujqësor në Shqipëri.

Sot, UBT luan një rol kyç në bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes partneriteteve strategjike, përfshirë Universitetin BOKU të Vjenës.



Për më shumë informacion vizitoni:

www.ubt.edu.al

info@ubt.edu.al

Rruga "Pajsi Vodica" Tiranë

MUNDËSI VAZHDIMI STUDIMESH (MASTER)

Të diplomuarit mund të vazhdojnë Master Shkencor në Inxhinieri Pyjore: me fokus në Menaxhimin Pyjeve, Kullotave dhe Zonave të Mbrojtura, Bioekonomi, GIS dhe fusha të ngjashme në Shqipëri dhe me mundësi të vazhdueshme për të marrë pjesë në Programe Erasmus në universitetet partnere europiane, përfshirë Universitetin BOKU - Vjenë.

FOLLOW US ON SOCIAL MEDIA



Agricultural University of Tirana



universiteti_bujqesor_tiranes
fakulteti_shkencave_pyjore



Universiteti Bujqësor i Tiranës - Faqja Zyrtare
Fakulteti i Shkencave Pyjore

Për jetën dhe të ardhmen...